



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija za imovinske zahteve Kosova

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/AR/101/2011
23/02/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën prej shtatëdhjetë e katër (74) kërkesave të identifikuara në listën e bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.
- (2) Në kërkesat me nr. 07868, 07870, 07871, 07873, 07875, 07877, 07878, 07880 dhe 90242, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores të UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të nxjerrë urdhër për riposedim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër

për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e një të nga 21 deri më 23 shkurt 2011 në Prishtinë. Gjithsej 2,632 kërkesa për pronë bujqësore dhe 35 kërkesa për pronë banesore i janë paraqitur Komisionit në seancën e njëzet e një të, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Megjithatë dy nga kërkesat bujqësore të paraqitura në Komision, u rikategorizuan nga Komisioni gjatë seancës si kërkesa për pronë banesore dhe përfshihen në vendimet e kërkesave për pronat banesore. Një kërkesë tjetër bujqësore dhe që i ishte paraqitur Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive në seancën e trembëdhjetë të Komisionit, por në të cilën Komisioni e ndërpreu vendimmarrjen në pritje të konfirmimit të notifikimit fizik të kërkesave për pronat e kërkuara, u tërhoq gjatë seancës. Gjithsej, 2,631 kërkesa bujqësore dhe 37 kërkesa për pronë banesore u shqyrtuan nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë vendosjen për kërkesën pronësore dhe të gjitha ato, me përjashtim të kërkesës nr. 30882, kanë të bëjnë me kërkesa për pronë bujqësore, përfshirë tokën bujqësore, luadhet dhe pyjet. Paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 30882, kërkon konfirmimin e pronësisë për një shtëpi dhe token e bashkuar asaj.

8. Ky vendim trajton 83 kërkesa, kryesisht 82 kërkesa për pronë bujqësore dhe një kërkesë për pronë banesore. Pjesa e mbetur prej 2,549 kërkesave për pronë bujqësore përfshihen në vendimet KPCC/D/A/100/2011, KPCC/D/A/102/2011 dhe KPCC/D/AR/103/2011. Pjesa e mbetur prej 36 kërkesave për pronë rezidenciale përfshihen në vendimet KPCC/D/R/104/2011 dhe KPCC/D/R/105/2011.

9. Gjithsej 31 kërkesa të përfshira në këtë vendim, janë shqyrtuar më herët nga Komisioni, ndërsa 52 kërkesa i janë paraqitur Komisionit për herë të parë. Megjithatë,

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

vendimi i mëparshëm për këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive, ose për shkak të gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë zbuluar pasi vendimi ishte marrë. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara dhe korrigjimit të gabimeve të tjera të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga çdo palë përgjegjëse e kërkesës ose çdo uzurpues aktual i pronave merren në shqyrtim nga Komisioni në rivendosjen e kërkesave. Në lidhje me kërkesat, vendimet e mëparshme të cilave janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar secilit paraqitës të kërkesave duke i informuar ata për gabimet e notifikimit dhe po ashtu i informon ata se kërkesat e tyre do të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara. Paraqitësit e kërkesave si dhe autoritetet kadastrale përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Një numër kërkesash të hedhura poshtë nga Komisioni në këtë vendim, ishin miratuar më parë nga Komisioni në një vendim të mëhershëm. Në rivendosjen e kërkesave, Komisioni merr në konsideratë informacionin e ri të marrë nga Sekretaria Ekzekutive ose të ofruar nga paraqitësi i kërkesës ose pala përgjegjëse në rrjedhën e ripërpunimit të kërkesave. Në situatat kur është ofruar informacion i cili ndikon në rezultatin e vendimit të mëparshëm, informacioni i tillë që tregon se nuk ka pasur humbje të posedimit dhe pamundësi për të ushtruar të drejtat pronësore për pronat e kërkuara, Komisioni vepron mbi bazën e informacionit të ri dhe mund ta hedhë poshtë një kërkesë e cila më parë ka qenë miratuar.

11. Komisioni vëren se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim janë jokontestuese në kuptimin se në kohën kur është bërë notifikimi i pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi për uzurpimin e paligjshëm, shfrytëzimin ose kultivimin e këtyre pronave nga ndonjë person, madje edhe nëse ka pasur dëshmi të tillë, asnjë pale nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës 30 ditore e përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat të cilat janë notifikuar gabimisht, janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'i ofruar çdo personi që ka interes ligjor në pronë, mundësinë për t'iu përgjigjur kërkesës në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse në listën e këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive i ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme përfshirë edhe notifikimin fizik të pronave dhe/ose përmes notifikimit të pronave nëpërmjet publikimit në gazeta dhe gazeta zyrtare, përmes autoriteteve komunale vendore, gjykatave komunale, udhëheqësve vendore të fshatit dhe përmes institucioneve të tjera përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionin e ofruar nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mundet t'i kenë uzurpuar pronat dhe cilindo person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronat e tilla, ashtu si e kërkon neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

12. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

13. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50, i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50.

14. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen në gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk përfaqëson çështje të gjykuar. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykate vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

1. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së provave për humbjen e posedimit.

15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

16. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që

ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

17. Kërkesa nr. 06984 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e tij si bartës i së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës informon se ai e ka trashëguar ngastrën e kërkuar nga gjyshi i tij edhe e ka shfrytëzuar tokën derisa u largua nga Kosova për në Serbi në vitin 1972. Ai e informoi Sekretarinë Ekzekutive se e kishte vizituar pronën e tij vetëm një herë para konfliktit në Kosovë dhe nuk e ka vizituar pronën qysh atëherë. Ai nuk ka dijeni për kushtet aktuale të pronës së edhe e informoi Sekretarinë Ekzekutive se humbja e posedimit për pronën nuk ndërlidhet me konfliktin në Kosovë gjatë 1998-1999. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të mandatit të Komisionit.

18. Në kërkesat nr. 26370, 26371, 26372, 26373, 26374, 26375 dhe 26378, paraqitësi i kërkesës, i cili ka depozituar kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, deklaron se u largua nga Kosova në vitin 1970 për në Serbi dhe vazhdon të shfrytëzojë pronat e tij që nga ajo kohë. Ai deklaron se asnjëherë nuk është zhvendosur nga konflikti edhe asnjëherë nuk ka humbur posedimin e pronave të tij. Ai e ka depozituar kërkesën për qëllimin e konfirmimit të së drejtës pronësore dhe për të garantuar sigurinë ligjore të pronësisë. Pasi nuk ka ndërhyrje në të drejtat pronësore të paraqitësit të kërkesës që të ndërlidhen me konfliktin, kjo kërkesë duhet të hidhet poshtë. (Shih gjithashtu vendimet e Komisionit KPCC/D/A/52/2009 të datës 19 gusht 2009, KPCC/D/A/65/2010 të datës 25 shkurt 2010 dhe KPCC/A/93/2010 të datës 28 tetor 2010 në të cilat Komisioni i ka hedhur poshtë kërkesat e depozituara nga i njëjti paraqitës i kërkesave për arsye të njëjta.)

19. Kërkesat me nr. 30880, 30881, 30882, 30883, 30884, 30885, 30886, 30888, 38704, 38705, 38706, 38707 dhe 38709 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e tij të bartësit të së drejtës pronësore. Të gjitha kërkesat janë për pronë bujqësore më përjashtim të kërkesës nr. 30882, e cila është për pronë banesore, pikërisht për një shtëpi edhe tokën e bashkuar me atë. Në gusht të vitit 2008, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se babi i tij ishte larguar nga Kosova në vitin 1980 dhe se prona është shfrytëzuar nga të afërmit e tij pas kësaj kohe. Ai shton se pas konfliktit, as ai edhe as familja e tij nuk kanë mundur të ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore për ngastrat e kërkuara e kjo për shkaqe sigurie. Në maj 2009, paraqitësi i kërkesës u kontaktua përsëri nga Sekretaria Ekzekutive për të sqaruar rrethanat nëse ai aktualisht ushtron të drejtat pronësore për ngastrat. Ai informoi se aktualisht nuk kishte pengesa për të shfrytëzuar ngastrën e kërkuar, por do të dëshironte konfirmimin e të drejtave pronësore në mënyrë që ta kishte më të lehtë për ta shitur pronën në të ardhmen. Ai deklaroi se prona ndodhet në Komunën e Leposaviqit, Komunë me popullsi kryesisht serbe në Kosovë. Për qëllimin e vërtetimit të mëtejshëm, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi nënën e paraqitësit të kërkesës, e cila informoi se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kishin banuar në Kosovë që nga vitit 1972, por se bashkëshorti i saj, i vizitonte pronat herë pas here. Ajo informoi se gjatë konfliktit të 1998-1999, pronat shfrytëzoheshin nga të afërmit e bashkëshortit të saj, të cilët asnjëherë nuk e humbën posedimin e pronave, ata nuk u larguan nga Kosova edhe vazhdojnë të banojnë në Kosovë. Bazuar në informacionin e ofruar nga paraqitësi i kërkesës, Komisioni konstaton se ai nuk ka humbur posedimin për pronën e kërkuar për arsye të konfliktit dhe aktualisht

nuk ka pengesa për ushtrimin e të drejtave pronësore. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë mandatit të Komisionit.

20. Kërkesat nr. 31384, 31385, 31386, 31387, 31389, 31390, 31391, 38666, 38668, 38672, 39069 dhe 39073 u depozituan fillimisht nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, pas vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore, pronat u trashëguan nga vëllai i tij. Fleta poseduese e cila konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës në këto kërkesa pranon se, as ai dhe as familja e tij nuk e kanë humbur posedimin e pronave për shkak të konfliktit. Kur u pyet se pse më parë kishte pretenduar se kishte humbur posedimin e pronave, ai deklaroi se familja e tij pati frikë për humbjen e posedimit të tokës pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Në këto rrethana, pasi nuk ka pasur humbje të posedimit të pronës së kërkuar për shkak të konfliktit të 1998-99, kërkesa duhet të hidhet poshtë. (Shih gjithashtu vendimin e Komisionit KPCC/D/A/70/2010 të datës 21 prill 2010 në të cilin Komisioni ka hedhur poshtë kërkesat nga i njëjti paraqitës i kërkesave për të njëjtat arsye).

2. *Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së provave për zotësinë e depozitimit të kërkesës në emër të bartësit të së drejtës pronësore.*

21. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

22. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë të bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat, stërgjyshërit dhe stërmbesat/stërnipërit e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, ky përkufizim nuk përfshin të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/ xhaxhallarët, tezet/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë ose kushërinj të tjerë më të largët, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore.

23. Kërkesat në të cilat lidhja midis anëtarit të bashkësisë familjare të paraqitësit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore nuk mund të vërtetohet, nuk mund të konsiderohet kërkesë e plotë në përputhje me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin. 03/L-079. Në kërkesa të tilla, nuk është

përbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtar i bashkësisë familjare.

24. Kërkesa nr. 38307 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në emër të nënës së tij, bartëse e së drejtës pronësore. Nëna e paraqitësit të kërkesës ka vdekur dhe Sekretarisë Ekzekutive i është ofruar certifikata e vdekjes. Emri i paraqitësit të kërkesës sipas letër njoftimit dhe certifikatës së lindjes është Nikola Filipovic. Në certifikatën e vdekjes, në certifikatën e vdekjes së bashkëshortit, në fletën poseduese dhe në certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme, emri i nënës së tij është shënuar si Zivka Stojanovic, por në certifikatën e lindjes së paraqitësit të kërkesës është si Zivka Filipovic. Sipas certifikatës së saj të vdekjes, mbiemri i vajzërisë së bartësit të së drejtës pronësore është Zivka Simijonovic. Emri i bashkëshortit të saj të ndjerë është shkruar në forma të ndryshme si Stanko Filipovic (në certifikatën e lindjes së paraqitësit të kërkesës), Stanko Stojanovic (në certifikatën e vdekjes) dhe Stanko Petrovic (në certifikatën e martesës). Ndonëse paraqitësi i kërkesës ka ofruar një deklaratë dëshmitari ku thuhet se Zivka Stojanovic dhe Zivka Filipovic janë i njëjti person, Komisioni e ka të pamundur të pranojë që deklaratat e dëshmitarit të përbëjë dëshminë e duhur në mungesë të dokumenteve dëshmuese. Komisioni vëren gjithashtu se certifikata e vdekjes dhe e martesës së Zivka Stojanovicit japin data të ndryshme të lindjes. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive në disa raste dhe iu kërkuar të ofrojë dokumente të cilat do të sqaronin mospërputhjen e emrit, por paraqitësi i kërkesës tregoi se nuk kishte më dokumente të tjera për të dorëzuar përveç atyre që tashmë kishte dorëzuar në Sekretarinë Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive u përpoq *ex officio* të vërtetojë nëse numri personal i identifikimit të bartësit të së drejtës pronësore ishte regjistruar në regjistrin e lindjeve dhe martesave pasi ky fakt mund të kishte vërtetuar nëse Zivka Stojanovic/Petrovic/Filipovic ishte i njëjti person. Megjithatë, numri personal i identifikimit nuk ishte i regjistruar në asnjë libër. I vetmi dokument që lidh paraqitësin e kërkesës me bartësin e së drejtës pronësore është certifikata e lindjes e paraqitësit të kërkesës, por nuk është dhënë asnjë shpjegim për ndryshimet në emrat në dokumentet e ndryshme që kanë të bëjnë me bartësin e së drejtës pronësore. Në këto rrethana, Komisioni nuk është i kënaqur që paraqitësi i kërkesës është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Kështu, kërkesa duhet të hidhet poshtë. Komisioni vëren se ai ka hedhur poshtë kërkesa të mëparshme nga i njëjti paraqitës i kërkesave për të njëjtat arsye; shih psh vendimin e Komisionit KPCC/D/A/61/2010 të datës 25 shkurt 2010.

25. Kërkesat nr. 44518 dhe 44526 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht bashkëshortja e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, Sekretarisë Ekzekutive nuk i është ofruar asnjë certifikatë vdekje. Emri i paraqitësit të kërkesës është Jelica Arsic, dhe emri i vajzërisë është Jelica Petrovic. Fleta poseduese dhe certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme tregojnë se bartësi i së drejtës pronësore është Filip Stolic. Në formularin e pranimit të kërkesës, bartësi i së drejtës pronësore është shënuar Filip Arsic, ndërsa në certifikatën e lindjes së paraqitësit të kërkesës e rilëshuar nga UNMIK-u më 2006, emri i bartësit të së drejtës pronësore është shënuar si Filip Staletovic. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës në vitin 2009 dhe i kërkoj asaj të ofrojë dokumente të vërtetuara nga autoritetet kompetente që konfirmojnë se Filip Arsic/Stolic/Staletovic është i njëjti person. Paraqitësi i kërkesës informoi se të gjitha dokumentet përkatës ishin në Prizren

dhe se ajo ishte shumë e moshuar për të shkuar në Prizren. Në janar 2010, Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi nipin e paraqitësit të kërkesës për të sqaruar mospërputhjen e emrit. Ai informoi se gjyshi i tij ishte regjistruar në mënyra të ndryshme në disa dokumente si Staletovic dhe në disa të tjera si Arsic, por se emri Stolic është vetëm një gabim administrativ. Ai tha se ishte përpjekur të merrte dokumente të vërtetuara në lidhje me mospërputhjen e mbiemrit të gjyshit nga gjykata e Krushevcit, Serbi dhe përmes zyrës së gjendjes civile, por zyrtarët e informuan atë të shkonte në Prizren për të marrë dokumentet përkatëse. Ai tha se paraqitësi i kërkesës nuk mund të shkonte në Prizren për shkak të situatës së sigurisë. Ai tha se bartësi i së drejtës pronësore vdiq në vitin 2004 në Lazarevc, Serbi dhe se certifikata e vdekjes shkruante emrin Arsic. Nipi informoi se ai do të ofronte certifikatën e vdekjes së gjyshit, kopjen letërnjoftimit të tij dhe shënime të taksave dhe do të përpiqej edhe njëherë të merrte një dokument të vërtetuar në lidhje me mospërputhjen e emrit. Megjithatë, ky dokument nuk është ofruar, dhe Sekretaria Ekzekutive nuk mund ta bëjë kërkesën në emër të paraqitësit të kërkesës. Në këto rrethana, Komisioni e ka të pamundur të vetëtojë identitetin e bartësit të së drejtës pronësore apo të jetë i kënaqur se paraqitësja e kërkesës është bashkëshortja e bartësit të së drejtës pronësore. Kështu, kërkesa duhet të hidhet poshtë. Komisioni vëren se ai ka hedhur poshtë kërkesa të mëparshme nga i njëjti paraqitës i kërkesave për të njëjtat arsye; shih psh vendimin e Komisionit KPCC/D/A/61/2010 të datës 25 shkurt 2010.

3. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.

26. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

27. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë të bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, përkufizimi nuk përfshin të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/xhaxhallarët, tezet/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë ose kushërinj të tjerë më të largët, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Individët të cilët nuk bien në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare nuk mund të konsiderohen paraqitës të kërkesave, por janë persona që synojnë të përfaqësojnë paraqitësin e kërkesës.

28. Kërkesat në të cilat lidhja midis anëtarit të bashkësisë familjare të paraqitësit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore nuk mund të vërtetohet, nuk mund të konsiderohet kërkesë e plotë në përputhje me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në kërkesa të tilla, nuk është përmbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtari i bashkësisë familjare.

29. Në kërkesën nr. 36546, personi që ka depozituar kërkesën është dhëndëri i bartësit të së drejtës pronësore. Pasi ai nuk ofroi autorizim nga anëtari i bashkësisë familjare, Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi bashkëshorten e tij, e cila është vajza e bartësit të së drejtës pronësore. Ajo ra dakord të autorizojë bashkëshortin për të kërkuar në emër të saj. Megjithatë nuk është marrë autorizim nga Sekretaria Ekzekutive. Kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi përsëri dhëndrin e bartësit të së drejtës pronësore, ai informoi se ai nuk donte të ofronte më dokumente pasi ai “nuk i besonte agjencisë”. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak të dështimit të paraqitësit të kërkesës për të ofruar autorizim për zotësinë e tij për të depozituar kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore.

30. Kërkesa nr. 36690, 36691 dhe 36693 janë depozituar nga anëtari i bashkësisë familjare, pikërisht i biri i bartësit të së drejtës pronësore. Ndonëse fleta poseduese që përfshin pronat e kërkuara është në emër të Rade Vasic, ngastra është e regjistruar në emër të Dragutin Stosic në bazë të një kontrate të ndarjes e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale e Kamenicës në vitin 1991 dhe është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Duket që ngastra më parë ka qenë në pronësi të Rade Vasic, i cili ia ka shitur tokenë babait të paraqitësit të kërkesës, Zivorad Stostic, i cili më pas e ka ndarë token midis dy vëllezërve të tij, xhaxhallarëve të paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës u informua për regjistrimin e pronës në emër të xhaxhait të tij dhe u ftua të dorëzojë autorizimin nga xhaxhai që të autorizonte atë të dorëzonte kërkesë në emër të tij. Paraqitësi i kërkesës informoi se ai do të dorëzonte autorizim, por nuk ka bërë kështu. Pasi paraqitësi i kërkesës dështoi të vërtetojë të drejtën pronësore të babait të tij dhe zotësinë e tij për të depozituar kërkesë në emër të bartësit aktual të së drejtës pronësore, kërkesa duhet të hidhet poshtë. Komisioni vëren se një numër i kërkesave të tjera të depozituar nga paraqitësi i kërkesës dhe të miratuara nga Komisioni kanë konfirmuar të drejtën pronësore të babait të paraqitësit të kërkesës.

31. Kërkesat nr. 37412, 37413, 37414, 37415, 37419, 37420, 37421, 37424, 51508, 51516, 51525 dhe 51526, janë depozituar nga mbesa e bartësit të së drejtës pronësore. Pasi paraqitësja e kërkesës nuk është anëtare e bashkësisë familjare me bartësin e së drejtës pronësore, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës në disa raste, duke i kërkuar të ofrojë autorizim nga bartësi i së drejtës pronësore ku të dëshmohet autorizimi i tij për të depozituar kërkesë. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi gjithashtu bashkëshorten e paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, në vend që të ofronte autorizim nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të së drejtës pronësore, me anë të të cilit të autorizonin paraqitësin e kërkesës për të paraqitur kërkesë, paraqitësi i kërkesës i ofroi Sekretarisë Ekzekutive një autorizim në të cilin ai autorizonte djalin e bartësit të së drejtës pronësore për ta përfaqësuar atë si paraqitës të kërkesave. Ky autorizim nuk përbën një autorizim as nga bartësi i së drejtës pronësore dhe as nga anëtari i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Për rrjedhojë, pasi

paraqitësi i kërkesë dështoi të vërtetojë zotësinë e tij për të depozituar kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me kërkesat e nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

32. Kërkesa nr. 51245 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht i thjeshtri i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka ofruar certifikatën e vdekjes të njerëzës së tij, por asnjë provë që dëshmon marrëdhënien e anëtarit të bashkësisë familjare me njerëzën. Po ashtu, paraqitësi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dokument përkatës të tilla si certifikata e martesës të babait të tij dhe njerëzës ose certifikatën e tij të lindjes. Komisioni vëren se bartësi i së drejtës pronësore nuk ka marrë mbiemrin e babait të paraqitësit të kërkesës pas martesës, por duket të ketë mbajtur mbiemrin e saj nga martesa e mëparshme. Paraqitësi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që ai është adoptuar formalisht nga njerka dhe as nuk ka ofruar vendim të gjykatës që tregon për ndonjë detyrim të njerëzës për ta mbështetur atë në pajtim me ligjin në fuqi ose ndonjë vendim trashëgimie që tregon se ai e ka trashëguar pronën e kërkuar. Në këto rrethana, paraqitësi i kërkesës nuk mund të konsiderohet anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak se paraqitësi i kërkesës nuk ka zotësinë për të depozituar kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Po ashtu, paraqitësi i kërkesës nuk ka provuar të drejtën e tij pronësore për pronën e kërkuar. Komisioni vëren se ai ka hedhur poshtë kërkesa të mëparshme për të njëjtat arsye; shih psh vendimin e Komisionit KPCC/D/A/84/2010 e datës 2 shtator 2010.

33. Personat që kanë depozituar kërkesat nr. 08466, 08469, 08471, 08473, 27560, 27561, 37086, 38293, 38294, 38296, 38297, 38298, 38299, 38303, 38304, 39505, 39509, 47388, 47389, 49375 dhe 51773, nuk janë anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me përkufizimin e mësipërm dhe për rrjedhojë duhet të tregojnë autorizimin e tyre për të vepruar në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, përmes një autorizimi të vlefshëm. Në të gjitha rastet, Sekretaria Ekzekutive i ka kontaktuar personat që kanë depozituar kërkesat, disa herë, ku u ka kërkuar të ofrojnë autorizimin nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtar i bashkësisë familjare i bartësit të së drejtës pronësore; megjithatë asnjë dokument i tillë nuk është ofruar. Në të gjitha kërkesat, personat që kanë depozituar kërkesa kanë treguar se ai/ ajo do të ofronin autorizimin nga anëtar i bashkësisë familjare, megjithatë ata kanë dështuar ta bëjnë këtë. Disa paraqitës të kërkesave kanë depozituar kërkesa të veçanta të cilat janë miratuar më parë nga Komisioni. Megjithatë, në këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore dhe nuk ka qenë e nevojshme për autorizim.

C. Kërkesa të refuzuara.

34. Në bazë të nenit 8.6 të aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50, Komisioni mundet të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë mbi çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore sipas rastit, nuk ka pasur mundësi

të dëshmojë në mënyrë të mjaftueshme pronësinë apo interesin për të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

35. Në bazë të nenit 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat për të drejtë pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo provë të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të bazohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmimeve të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

36. Kërkesat nr. 07868, 07870, 07871, 07873, 07875, 07877, 07878, 07880 dhe 90242 janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Kërkesat janë vendosur më herët në vendime të ndryshme të Komisionit gjatë vitit 2007. Megjithatë, këto vendime janë shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave në fjalë gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive. Komisioni i ktheu kërkesat për ripërpunim pas notifikimit të saktë të pronave. Në kohën e vendimeve të mëparshme, paraqitësi i kërkesës ishte bartësi i së drejtës pronësore. Megjithatë, tani paraqitësi i kërkesës konfirmon se ai e ka shitur pronën tek një palë e tretë në vitin 2009 në bazë të kontratës së shitblerjes nr. 79/109. Certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme, e cila është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive, është regjistruar në emër të pronarit të ri. Djali i paraqitësit të kërkesës informoi se ai do të dorëzonte kontratën e shitblerjes dhe do të tërhiqte kërkesat. Megjithatë nuk është marrë asnjë tërheqje formale nga Sekretaria Ekzekutive. Pasi paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se ai nuk është më bartës i së drejtës pronësore, kërkesa duhet të refuzohet nga Komisioni për dështimin e paraqitësit të kërkesës për të vërtetuar të drejtat aktuale pronësore për pronat e kërkuara.

D. Vërejtje përmbledhëse.

37. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në këtë rast.

38. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtat e paraqitësve të kërkesave ose bartësve të së drejtave pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoriteteve kadastrale ose gjykatave vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA08466	KPA08469	KPA08471	KPA08473	KPA27560	KPA27561	KPA38293
KPA38297	KPA38298	KPA38303	KPA38304	KPA39505	KPA39509	KPA47389
KPA51773	KPA36690	KPA36691	KPA37421	KPA51516	KPA51526	KPA37412
KPA37413	KPA37419	KPA37420	KPA47388	KPA51508	KPA51525	KPA51245
KPA31387	KPA37086	KPA37414	KPA37415	KPA37424	KPA38668	KPA44526
KPA36693	KPA38307	KPA44518	KPA49375	KPA06984	KPA36546	KPA38294
KPA38296	KPA38299	KPA38666	KPA30881	KPA30883	KPA30884	KPA30886
KPA38704	KPA38707	KPA31384	KPA31385	KPA31386	KPA31389	KPA31390
KPA31391	KPA38672	KPA39069	KPA39073	KPA30880	KPA30885	KPA30888
KPA38705	KPA38706	KPA38709	KPA26370	KPA26375	KPA26378	KPA30882
KPA26371	KPA26372	KPA26373	KPA26374			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA07868
KPA07870
KPA07871
KPA07873
KPA07875
KPA07877
KPA07880
KPA90242
KPA07878